

VALBONA SINANAJ

HUAZIMET DHE KALKET GJUHËSORE NË GJUHËN SHQIPE

“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!” (Faik Konica)

“Gjuha pasqyron një kombësi ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture. Pastrimi i gjuhës nga ky mish i huaj është një detyrë shkencore, njëkohësisht edhe kombëtare” (Çabej, 1981:1).

Huazimi është një fjalë, një strukturë sintaktike, një morfemë ose një fonemë e huaj, që hyn dhe bëhet pjesë e pasurisë së një gjuhe të caktuar, bëhet fjalë për një lloj neologjizmi. Me huazim, nënkuptohet edhe fenomeni i përshtatjes së fjalës së huaj. Në një shoqëri të hapur, siç është sot shoqëria shqiptare, ndihet trysnia e gjuhëve të tjera, sidomos i atyre me të cilat jemi në kontakt. Faktorët që ndikojnë në ekspansionin gjuhësor janë të shumtë. Faktori i parë është thjesht gjuhësor, por roli i tij është shumë i vogël. Ky faktor është i ndjeshëm në gjuhët në kontakt dhe në gjuhët me afri gjenetike. Faktori i dytë është ekonomik, p.sh. përhapja e anglishtes ekonomike të SHBA-së në tregun botëror. Faktori i tretë është ai politikë ndërkombëtare, rritja e prestigjit politik lidhet me rritjen e prestigjit ekonomik dhe me aftësinë imponuese në fushën e kulturës dhe të gjuhës. Faktori i katërt është ai psikologjik e sociologjik dhe së fundi faktori demografik (Rrokaj, 2007: 118-119).

Huazimet ndahen në: **Huazime të domosdoshme**, fjalët që hyjnë, kur zbulohet një objekt i ri që i referohet diçkaje të re (p.sh. *bankomat*). **Huazime të luksit**, sipërfaqësor, që do të thotë, ekziston fjala në gjuhë me të njëjtin kuptim, por përdoren termet e reja për një sfumaturë të veçantë ekspresive që përmbajnë (p.sh. *show, manaxher, baby-sitter*). **Huazime të jointegruara**, pra fjalët e pranuar në formën e tyre origjinale (p.sh. *bar, tram*). **Huazime të përshtatshme**, dhe mbi të gjitha kalket gjuhësore (p.sh. it. *bistecca* – bisteka nga ang. *beff* – *steak*).

Kur folësi dëgjon për herë të parë fjalën e re, e ndjen si diçka të huaj sa nuk arrin ta kuptojë, pavarësisht faktit nëse bëhet fjalë për huazim apo për krijim ‘ex novo’. *Folësi në momentin e huazimit*, – pohon E. Haugen – *ribashkon në sistemin e tij gjuhësor imazhin e modelit të huaj* (Haugen, 1950: 761).

Thelbi i huazimit qëndron në mënyrën, sesi është organizuar në krahasim me modelin e huaj dhe nuk qëndron në formën e fjalës kriteri vendimtar për të njohur huazimin (Hjelmslev, 1970: 251). Kur neologjizmi identifikohet në aspektin e tij të dyfishtë, formal dhe semantik, ai pushon të shfaqet si diçka i huaj dhe anomal. Huazimi përshtatet në sistemin fonologjik (dhe ndonjëherë dhe në sistemin

ortografik) të gjuhës që e merr p.sh. orientalizmat (it. *caffè* – shq. *kafë*, vijnë nga arabishtja *qahwa* nëpërmjet turqishtes *qahve*). Ndonjëherë fjala merret siç është, pa e zëvendësuar huazimin ose pa e kamufluar. Kjo mund të përcaktohet nga mbizotërimi i një gjuhe të huaj në një sektor, p.sh. ligjërimi informatik i gjuhës angleze, nga ku kemi në ital. *scanner*, *mouse*.

Huazimet nga italishtja në gjuhë të tjera u detyrohen karakteristikave të komuniteteve të ndryshme gjuhësore, që kanë njohur konceptet nëpërmjet ndonjë kontakti me italishten. Mbi të gjitha, për arsye historike huazimet nga italishtja përqendrohen në sektorë të veçantë, p.sh. në atë financiar (angl. *bank*, shq. *banka*, gjerm. *konto*, *kredit*, shq. *kredi*). Për fushën leksikore të artit, huazimet kanë të njëjtën vlerë pak a shumë në gjuhë të ndryshme evropiane: për muzikën, ital. *viola*, *piano*; për artet figurative, kemi në frëngjisht italianizmat si *aquarelle*, *graffiti*.

Kontaktet me latinishten kanë sjellë në shqip shumë huazime: lat. *medicus* – shq. *mjek*, lat. *medicaster* – shq. *hiesira*, lat. *spiritus* – shq. *shpirt*, lat. *vestis*, *vestimentum* – shq. *veshje*, *mbathje*, lat. *magistru* – shq. *mjeshtër*, lat. *caballu* – shq. *kalë*, lat. *scala* – shq. *shkallë* (Çabej, 1982: 59).

O-ja e periudhës prehistorike indoevropiane dhe e periudhës latine në shqip ka dhënë *vo-* në fillim të fjalës në gegërisht dhe *va-* në toskërisht: lat. *oleum* – shq. *voj*, *vaj*, lat. *orphanus* – shq. *i vorfën*, *i varfër*, lat. *opus*, *operis* – shq. *vepër*, lat. *orbis* – shq. *i verbër*, lat. *vallis bona* – shq. *Valbona* (luginë e mirë) (Beci, 2002: 39).

Kalket gjuhësore

Kalku gjuhësor është një fenomen i ndërhyrjes gjuhësore, që ndryshe nga huazimi gjuhësor, përfshin ato raste të ndërhyrjes (interferencës) në të cilat imitimi është limituar në ‘*innere Sprachform*’ dhe nuk riprodhon veçse domethënien, aspektin e jashtëm të modelit të huaj. Kalku mund të jap një element të ri gjuhësor që, megjithëse kombinon materialin ekzistues në gjuhën që imiton, pasuron inventarin leksikal të vetë gjuhës. Bëhet fjalë, për një fenomen të një procesi mimetizues më të rafinuar në krahasim me huazimin, i cili shfrytëzon materialin gjuhësor paraekzistues në gjuhën ku përsëritet. Ata ndahen në **semantikë** dhe **formalë**, duke marrë parasysh ambiguitetin e konceptit të ‘formës’ (veshja tingullore e fjalës), preferohet emërtimi i *kalkut struktural*. Për të verifikuar llojin e kalkut nëse është *struktural* apo *semantik*, duhet që modeli i huaj të përmbushë regjistrin e të pasurit një domethënie për folësin (të jetë një fjalë ‘transparente’, e motivuar në strukturën e saj) (Ulmann, 1970: 131).

Nëse, modelit i mungon motivimi (karakterizohet vetëm nga emërtimi) ose nëse folësi nuk është në gjendje ta perceptojë, verifikohet fenomeni i ndërhyrjes gjuhësore (një huazim), asnjëherë një kalk, i cili nënkupton një shkallë të bilinguizmit më të avancuar të huazimit. Fjala ang. *outlaw* është riprodhuar në italisht me *fuoriligge* sepse është transparente në motivimin e saj të dyfishtë, semantik she struktural.

Kalku semantik është lloji i kalkut më kompleks, pasi lejon ndryshimin e funksionit semantik nga një njësi ekzistuese, me riorganizim pauses semantik në

një njësi të gjuhës që i kundërpërgjigjet. Kalku semantik supozon plotësimin e këtyre kushteve:

Polisemia e modelit aloglot: Kalku semantik supozon, që domethënia e modelit qoftë e shpjegueshme si i nyjësuar në tipare semantike, të cilat vetëm në pjesë gjejnë përkime në një njësi leksikale të gjuhës tjetër.

Pikasja e raportit të motivacionit ndërmjet tipareve semantike të larmishme të modelit. Domethënia e përgjithshme është konsideruar fundamentale në dy elementet gjuhësore (modeli dhe replica), dhe interpretohen si dytësore, pra motivimi i kuptimeve që nuk përputhen në gjuhën ku përsëriten klasifikohen si përdorime metaforike ose përdorime teknike (Gusmani, 1993: 229).

Kalku qëndron në puqjen e funksioneve semantike të dy fjalëve (modeli dhe replica), ndërmjet të cilave është ndërtuar raporti i bazuar mbi bashkësinë ekskluzive të tipareve semantike (ky është përcaktuar edhe një fenomen i ‘polisemisë induktive’). Pra, ai që vendos në lëvizje kalkun semantik është kontrasti, i paralajmëruar nga binliguisti, për efekt të përputhshmërisë vetëm të pjesshme të tipareve semantike: kalku semantik ngulitet tamam në këtë divergjencë semantike të dy fjalëve të përbashkëta, p.sh. angl. *hawk*, ital. *falco*, është kalk që i referohet përkrahësve në problemet internacionale, i një linje drastike dhe të papajtueshme (GRADIT, nga 1996, krahasuar me angl. *Hawk*). Për kalkun semantik replica italiane, mbi bazën e papajtueshmërisë semantike me modelin e huaj (në këtë rast angloamerikan), zgjeron spektrin e tij semantik derisa të marrë tiparin semantik të kuptuar si dytësor. Sot fjala ka përdorim të gjerë në leksikun gazetaresk (p.sh. *i falchi e le colombe*) duke iu referuar përkrahësve në problemet internacionale, të linjës drastike dhe të papajtueshme.

Ital. *pagare* (shq. *paguaj*) merr domethënien e ‘*essere vantaggioso*’, për kalkun semantik mbi angl. *to be profitable or advantageous*, ‘*salvare*’, ‘regjistruar nella memoria centrale’ të arkivosh të dhënat, është modeluar në angl. ‘*to save*’.

Bëhet fjalë për novacione që nuk prishin sistemin e gjuhës huadhënëse, duke qenë fjalë rrënjëse të përdorshme me domethënie të panjohura. P.sh. anglicizmat tipologjikisht të klasifikueshëm, territori semantik i njësive leksikale të trashëgueshme apo të pasurisë shkon drejt një zgjerimi pasqyrues në lidhje me një model e huaj.

Kalku supozon një shkallë kontakti më të përparuar dhe kompleks se huazimi, dhe ka një karakter përgjithësisht të ngritur. Janë kalke që riprodhojnë besnikërisht domethënien e modelit aloglot p.sh. në shq. kalket *paradhomë* – it. *anticamara*, shq. *i arsyeshëm* – it. *ragionevole*, shq. *keqbërës* – it. *malfattore*, shq. *mirëbërës* – it. *benefattore* etj. (Çabej, 1982: 135).

Kalku struktural. Bëhet fjalë për një fenomen të ndërhyrjes gjuhësore, që qëndron në riprodhimin e një modeli të huaj nga këndvështrimi i strukturës dhe të domethënies, që zbatohet duke përdorur materialin gjuhësor paraekzistues në gjuhën imituese. Kalku struktural lejon formimin e një neologjizmi mbi imitimin e një modeli aloglot dhe ndahet, sipas strukturës së përzier në: **kalk struktural i ribashkuar**, **kalk struktural i shmangur** (Gusmani, 1993: 277).

Kalku struktural i ribashkuar. Për t'u verifikuar ky kalk, folësi duhet të perceptojë motivimin formal dhe semantik të modelit të huaj ose raportin semantik ndërmjet përbërësve, domethënien dhe njësinë leksikore. Folësi duhet të jetë në gjendje të përfundojë analizën e dyfishtë të të shënuarit dhe të shënjuesit të gjuhës model në njësitë e saj më të thjeshta: duhet të riprodhojë në një gjuhë tjetër, me anë të njërive tashmë ekzistuese një element të ri leksikor, që të ketë të njëjtin artikulum struktural dhe të njëjtin motivim semantik të termit të marrë si model: angl. *skyscraper* përgjigjet në ital. *grattaciello*, në shq. *qiellgërvishës*. Përsëritja klasifikohet si kalk struktural i papërfunduar, për arsye se struktura përbërëse e huaj riprodhohet besnikërisht në domethënie e *edificio didimensioni molto grandi*; por vihet re përmbysja e rendit të përbërësve, për arsye se përsëritja i përshtatet traditave gjuhësore ekzistuese, që marrin në rastin kur bëhet fjalë për një element të përbërë p.sh. ital. *portacenere, apribottiglie*, ku elementi verbal është në fillim të pozicionit. Ndërrimi i rendit të përbërësve përcakton papërsosmërinë e përsëritjes që karakterizon **kalkun struktural të bashkuar**.

Angl. *flatfoot* – ital. *piedipiatti* 'polici', angl. *outlaw* – ital. *fuorilegge* 'kriminal', dhe në këtë rast bëhet fjalë për dy kalke strukturale të bashkuara të llojit të papërsosur dhe të përsosur: përsëritjet riprodhojnë besnikërisht strukturën e përbërë dhe domethënie e modeleve, por përmbysin rendin e përbërësve të huaj që parashikojnë më parë objektin në krahasim me emrin, ndërsa në rastin e dytë kemi një kalk perfekt. Një shembull i kalkut imperfekt në italisht është *portabandiera* në shqip *flamurbajtës*.

Kalku struktural i shmangur. Në rastin e një kalku të shmangur, korrespondenca e vendosur ndërmjet morfemave të dy gjuhëve ka një karakter shumë më të përgjithshëm dhe të lirë, se ajo që ka në mes elementëve të një kalku të bashkuar, kështu që shkalla e ndërvartësia nga modeli rezulton më pak i theksuar dhe përpjesëtimisht më e madhe autonomia e atij që kryen kalkun. P.sh. lat. *atramentum* nuk e ka prejardhjen drejtpërdrejt nga *ater* 'nero', por nga **artrare* 'scrivere con l'inchiostro', *latria* 'scrivere', sidoqoftë jo më i dëshmuar.

Kalku sintagmatik. Kemi kalk të tillë, në ato raste kur modeli dhe riprodhimi kanë pamjen e 'sintemave' (në terminologjinë e përdorur nga A. Martine, segmenti minimal i një fraze i formuar nga monema leksikale) pra njësi leksikale komplekse, të nyjëzuara në përbërës të pajisur në autonomi semantike, në kontekste të tjera, por mbartës në kombinim e një domethënie të harmonishme, jo të reduktueshme në shumën e domethënieve të elementëve përbërës: p.sh. it. *guerra fredda* – shq. *luftë e ftohtë*, shprehje e përdorur në lidhje me gjendjen e tensionit politik ndërmjet U.S.A dhe U.R.S.S në vitet pasuese në fund të luftës së dytë botërore, që mbajti edhe vlerën e gjerë të 'një gjendjeje të një tensioni të lartë ndërmjet dy shteteve pa veprime luftarake' (Castamana, - Giannini, 1997: 24). Modeli frymëzues është angl. *cold war*, aktualisht sintagma në fjalë njihet përdorim të gjerë me një domethënie të përhapur 'guerra fredda nei rapporti interpersonali' (Gusmani, 1993: 280).

Kalku i pjesshëm ose kalk - huazim. Një shembull është ital. *'trust di cervelli'*: me këtë shprehje njihet grupi i ekspertëve, i këshilltarëve të krijuar për të

diskutuar dhe zgjidhur probleme të natyrave të ndërlikuara dhe të rëndësishme në drejtimin politik, ekonomik dhe administrim. Modeli i kalkut është sintagma angl. *brain trust*, e riprodhuar edhe si huazim besnik edhe si kalk – huazim. Një shprehje e përgjithshme në shumë gjuhë evropiane është p.sh. *me hekur e me zjarr* – it. *a ferro e fuoco* (Di Giovine, 2010: 113).

Ndikime të huaja sintaksore në gjuhën shqipe

Hapja e shqipes ndaj gjuhëve të tjera ka sjellë shtimin e huazimeve në sistemin leksikor dhe semantik të saj. Në shqipe, nga gjuhë të huaja, sidomos nga anglishtja, kanë hyrë shumë fjalë si *huazime historike-kulturore*, që janë të pashmangshme, dhe në fund të fundit, pasurojnë leksikun e shqipe. Nëngrupin kryesor të këto huazime e përbëjnë termat e të gjithave fushave, një pjesë e madhe e të cilave sa vjen dhe e zgjeron përdorimin në shtresa të ndryshme shoqërore. Periudha kalimtare e viteve 1991-2001, po ta kthejmë në terma sociolinguistikë, do të thotë: *kalimi nga një vlerësim shumë i lartë për gjuhën e kulturën kombëtare në një liri të plotë e në një qëndrim gati hapur të pakujdesshëm ndaj gjuhës në përgjithësi*. Vrulli për të mësuar sa më shpejt gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten; kujdesi shumë i pakët e, ndonjëherë, edhe shpërfillje e gjuhës letrare, ka çuar në vërshim të përshtuar dhe të pafrenueshëm të fjalëve të huaja të panevojshme në shtim të termave të huaj në vend të termave shqip, p.sh. *Parlament* në vend të fjalës *Kuvendi*. Kanë hyrë e nuk pushojnë së hyri edhe jo pak mënyra të thëni a ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen, thjesht si ndikim nga gjuhët e huaja si: *Komisioni bipartisan* në vend të *Komisioni dypalësh*.

Fjalët e huazuara, sidomos anglicizmat, vijnë në shqip në kushtet e një dygjuhësi të çalë, shpesh ka edhe ngatërresa kuptimore të fjalëve; p.sh. *kompromis* e *konsensus* janë fjalë me kuptime të dallueshme: *konsensus-i* (= të merresh vesh, marrëveshje); *kompromis-i* (= lëshim, të bërët lëshime; në parime etj.).

Pasurimi është shfaqje e zhvillimit dhe përparimit të gjuhës dhe buron pikërisht nga zhvillimi i gjithanshëm i jetës dhe i vendit. Pasurimi i gjuhës është proces ligjor objektiv, në të cilin marrin pjesë e veprojnë çdo ditë njerëzit e thjeshtë, teknikët, shkrimtarët, artistët, mësuesit etj. Rruga kryesore e pasurimit të gjuhës me fjalë që i duhen, është formimi i fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës dhe sipas modeleve prodhimtare të sistemit fjalëformues të shqipes, ose nëpërmjet shqipërimit të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja. Të tilla janë p.sh. *domosdoshmëri*, *gatishmëri*, *qëndrueshmëri*, *mbingarkoj*, *mbivlerë*, *nënujor*, *përvijoj*, *ideor*, *parimor* etj. Rrugë tjetër për pasurimin e shqipes është përdorimi më i gjerë i fjalëve dhe frazeologjizmave nga goja e popullit, të cila në mjaft raste mund të shërbejnë edhe për të zëvendësuar fjalë të huaja të panevojshme, p.sh. *grimcë* në vend të *partikulë*, *kah-u* në vend të *sens-i*, *mjedis* në vend të *ambient* etj. Për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare mund të rimerren edhe fjalë të bukura, që kanë qenë krijuar në epoka të mëparshme por që, për arsye të ndryshme, nuk kanë gjetur përdorim e kanë mbetur mënjanë. Të tilla janë, p.sh. *trimëroj* në vend të fjalës së huaj *inkurajoj*, *nismë*, *nismëtar* në vend të *iniciativë* *iniciato*, *miratoj* në vend të *aprovoj* etj.

Huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur tashmë vendin e tyre në gjuhë. Mbi këtë bazë mund të dallojmë:

- Fjalë me burim të huaj që janë bërë njësoj si fjalët e tjera të leksikut të shqipes. Hyjnë këtu huazimet e vjetra si: *qytet, shëndet, faqe, presh, xhep, rrugë, mjeshtër, rrugë, këndoj, kusi* etj., dhe fjalët ndërkombëtare: *analizë, aritmetikë, demokraci, diktaturë, filozofi, filologji, gramatikë, kongres, parti, roman, komedi, subjekt, balet* etj.

- Fjalë me burim të huaj, të cilat me kohë kanë dalë nga përdorimi i gjerë, për shkak se janë zhdukur vetë sendet a nocionet që shprehin ato (*breshanë, xhandar, kumbra*), ose janë zëvendësuar me fjalë shqipe (*qatip, qitap, imza*). Ndodh që brenda çerdhes së fjalëve të huazuara disa fjalë janë zëvendësuar me fjalë shqipe, kurse disa të tjera, të së njëjtës çerdhe, nuk janë zëvendësuar, p.sh. *nacion, nacionalitet* dhe *internacional* janë zëvendësuar me fjalët shqipe *komb, kombësi, ndërkombëtar*, kurse *nacionalist, nacionalizëm, internacionalist, internacionalizëm* nuk janë zëvendësuar.

- Fjalë të huaja të panevojshme, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalët shqipe ekzistuese ose të krijuara me brumin e shqipes, sipas gjedheve të gjuhëve të tjera. Të tilla janë p.sh. *weekend* që po zëvendësohet me *fundjavë*, e krijuar sipas modelit të anglishtes, por me mjete të shqipes (Shkurtaj, 2015:66-69).

Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Por, ndërsa pranonte domosdoshmërinë e fjalëve të huazuara me karakter ndërkombëtar e më gjerë, kur ato janë të pamënjanueshme e të vlefshme për shqipen, Çabej theksonte se në shumë fusha të shkencës, të artit, të kulturës “*ka një mori fjalësh të vendit, që pa dëm kuptimor janë në gjendje t’ua zënë vendin fjalëve të huaja*” dhe shtonte se “*aty është me interes se fjalët e vendit kuptohen më mirë, rroken e përvetësohen më mirë nga nxënësit e moshave të vogla, sepse u formojnë atyre shoqërimi idesh; ato gjejnë ngjashmërinë e vet në pasurinë leksikore që zotërojnë ato brenda sistemit të gjuhës amtare*” (Çabej: 1981: 1).

BIBLIORAFI

- B. Beci, *Lashtësia*, Tiranë, 2002, f. 39.
 E. Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, në “Gjuha jonë”, Tiranë, 1981.
 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, 1982.
 E. Haugen, *The Analys of linguistic Borrowing*, in Language, 1950.
 Gj. Shkurtaj, *Urgjenca Gjuhësore huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe*, Tiranë, 2015.
 L. Hjelmlev, *Il linguaggio*, Torino, 1970.
 L. Castamagna-S.Giannini (1997), *Interferenza linguistica* in Atti del Convegno della società, 1997.
 R. Gusmani, *Saggi sull’interferenza linguistica*, II ed. Le lettere, 1993, f. 229.
 S. Ulmann, *La semantica, introduzione alla scienza del significato*, trad. Ital, Il Mulino, Bologna, 1970.
 Sh. Rrokaj, *Hyrye në gjuhësinë e përgjithshme*, Ilar, Tiranë, 2007.
 P. Di Giovine, *Gli italianismi in albanese*, in Serianni, L., I vol, Torino UTET, 2010.